

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mes brirëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roca Rey rikthehet në arenë dhe triumfon
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/mes-brireve-te-demit-540-kilogramesh-per-mbi-10-sekonda-roca-rey-rikthehet-ne-arene-dhe-triumfon/1011572/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:11:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:07:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ad7f655968b7e276db44ee9e00e095539076aceede8f0e508393918e0e37ede4
TEKSTI	c604b878d1e636357b4c76309d5388bdc082b87bf6a48def19e3b324ba417e9f
PAMJA	fbda81f708cb35a0e801465170e16fc0e4915ac2b82ea3e76536ef322dc73901

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	745575385710ac53abb36f62f058b0ab9aadb610b5cd6446bdfc7ec941430667
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/745575385710ac53abb36f62f058b0ab9aadb610b5cd6446bdfc7ec941430667>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mes brirëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roca Rey rikthehet në arenë dhe triumfon



Një incident i frikshëm u regjistrua më 12 shtator në arenën e Arles, në jug të Francës, gjatë aktivitetit Feria du Riz. Toreadori peruan Andrés Roca Rey u kap nga brirët e një demi 540 kilogramësh dhe u tërhoq zvarrë nëpër arenë për disa sekonda.

Kafsha, e quajtur Vicioso, ishte demi i pestë që doli atë pasdite. Në pamjet e publikuara shihet momenti kur ajo sulmon Roca Rey, e ngre 29-vjeçarin nga toka dhe e mban të bllokuar mes brirëve.

Ndërsa përpiqej të çlirohej dhe të mbahej pas kafshës, demi vazhdoi të lëvizte nëpër arenë. Situata zgjati më shumë se dhjetë sekonda, deri në ndërhyrjen e kolegëve dhe ndihmësve të toreadorit.

Rreth dhjetë persona u afruan për të ndaluar demin dhe për ta nxjerrë Roca Rey nga brirët. Më pas, toreadorë të tjerë përdorën pelerinat për ta tërhequr vëmendjen e Viciosos dhe për ta larguar atë nga 29-vjeçari.

Megjithëse sapo kishte kaluar një moment të rrezikshëm, Roca Rey vendosi të mos largohej nga arena. Vetëm pak minuta më vonë, ai u kthye për të vazhduar përballjen me Vicioson.

Rikthimi i tij u mbyll me sukses. Për përballjen me këtë dem, peruanit iu dhanë dy veshë dhe një bisht, ndërsa në përfundim të gjithë pasdites ai grumbulloi tre veshë dhe një bisht.

Andrés Roca Rey cilësohet si një prej figurave më të rëndësishme të ndeshjeve moderne me dema. Qasja e tij tepër e guximshme dhe fakti se afrohet shumë pranë kafshëve i kanë sjellë famë të madhe, si edhe nofkën "Messi i toreadorëve".

Roca Rey ka lindur në Peru, por në moshën 13-vjeçare u transferua në Spanjë për të ndjekur karrierën

të fundit /



Mes brirëve të demit 540 kilogramësh për mbi 10 sekonda, Roc...



Rodri: Barcelona duhet të jetë më e disiplinuar në mbrojtje



Mbyllen fjalimet para Kryeministritë, protestuesit marshojn...



Trump kundër ngadalësimit të AI-së: SHBA duhet të ruajë...



Avioni privat i nisur nga Holanda përplasat në një fushë në Gjerman...



Liverpooli vëzhgon edhe Alejandro Balden pas marrëveshjes për...



iOS 27 mbërrin sot: Ja kur pritet të jetë i disponueshëm dhe ci...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

profesionale si toreador. Me vone ai mori edhe shtetesine spanjolle. Përpara ndeshjes ne Aries, dasnkia e qytetit bëri të ditur se ai kishte fituar 50 "veshë" në 28 ndeshje me dema gjatë vitit 2026.



Rreziku nuk është i panjohur për 29-vjeçarin. Në muajin prill, gjatë një ndeshjeje në Sevilje, një dem e goditi dhe e ngriti në ajër, duke i shkaktuar një plagë të thellë në këmbë.

Një tjetër episod u filmua në tetor të vitit 2024, kur Roca Rey u përpoq të hidhej nga brirët e një demi. Pasi ra në tokë dhe u përpoq të mbrohej, kafsha e sulmoi sërish, i kapi uniformën me brirë dhe e tundi fuqishëm, derisa ndërhyrë toreadorë të tjerë.

Përballjet me dema e kanë vënë në rrezik që në fillim të karrierës. Ai u plagos nga një dem në pesë paraqitjet e para, ndërsa një sulm tjetër i fuqishëm në vitin 2016 u pasqyrua gjerësisht në media.

Ngjarjet e fundit kanë rindez diskutimet për ndeshjet me dema, traditë e hershme sidomos në Spanjë, por që po kritikohet gjithnjë e më shumë për mënyrën se si trajtohen kafshët.

Një sondazh i vitit 2025, i cituar nga mediat britanike, tregoi se rreth 77% e spanjollëve janë kundër këtyre ndeshjeve. Te grupmosha nën 35 vjeç, kjo shifër kalon 80%.

Pavarësisht rrezikut dhe debatit që e shoqëron këtë traditë, përballja me demin 540 kilogramësh nuk e ndali Roca Rey. Ai u rikthye në arenë, u përball përsëri me Vicioson dhe e mbylli performancën me triumf.

Shtuar më 14.09.2026 21:07



Trump kundër ngadalësimit të AI-së: SHBA duhet të ruajë epërsinë ndaj Kinës



Avioni privat i nisur nga Holanda përplasat në një fushë në Gjermani, humb...



The Guardian": Azilërkuesit e kthyer nga Britania në Francë...



Sistemi EES për kontrollet kufitare përballet me vonesa, nëntë vende të B...



Shuhet në moshën 107-vjeçare Yehuda Widawski, i mbijetuari më i vjetër i...



Trump kritikon drejtuesin e Anthropic: SHBA-ja kryeson Kinën në garën ...



Der Spiegel: Mbi 24% e vullnetarëve nuk plotësojnë kushtet fizike për...



Rutte: Sulmi rus ndaj trenit pranë kufirit polak nuk do të zbehtë mbështetjen...



Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.